

Vendim nr. 107 datë 20.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marjana Semini, Anëtare
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 20.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (E) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: EDMOND KASMI

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes së procesit të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës së aksesit dhe së drejtës për t'u dëgjuar e gjykuar nga gjykata e posaçme e caktuar me ligj.

Hetimi dhe gjykimi brenda afateve të arsyeshme për subjektet dhe veprat e posaçme penale referuar nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

Konstatimi i shkeljes së barazisë para ligjit.

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023- 2186, datë 19.12.2023 të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pezullimi i zbatimit të tij, duke urdhëruar rishqyrtimin e çështjes së mosmarrëveshjes lëndore përpara Gjykatës së Lartë dhe çdo masë tjetër të përshtatshme për rivendosjen e të drejtave themelore ndaj kërkuarit dhe të afërmeve të tij, të cilët kanë ose duhet të kenë statusin e viktimës në një çështje penale.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin

**e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të
ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Edmond Kasmi në vitin 2020 ka kandiduar për t’u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, në profilin “gjyqtar”, në Shkollën e Magjistraturës. Gjatë procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, ai është vënë në dijeni të një problematike lidhur me shitjen e një apartamenti, në janar të 2019-ës. Sipas kërkuesit, ndonëse në kontratë ishte parashikuar se çmimi i shitjes kalonte nga llogaria e noteres në llogarinë e Fondit Besa për shlyerjen e një kredie të marrë prej tij, ky veprim nuk është realizuar.

2. Në këto rrethana, kërkuesi në datën 23.05.2023 ka paraqitur kallëzim penal pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), kundër ministrit të Drejtësisë dhe disa funksionarëve të Dhomës Kombëtare të Noterisë lidhur me përgjegjësinë e tyre për inspektimin e veprimtarisë noteriale, si dhe noteres që ka lidhur kontratën e shitjes dhe blerëses së apartamentit, me pretendimin se ata kanë kryer veprat penale “Korrupsioni aktiv në sektorin privat”, “Korrupsioni pasiv në sektorin privat”, “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, “Përfitimi i paligjshëm i interesave”, “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, “Falsifikimi i dokumenteve”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Moskallëzimi i krimit”, të kryera në bashkëpunim midis tyre, si pjesë e një grupi kriminal në sektorin financiar.

3. Prokuroria e Posaçme, me shkresën nr. 388/1 prot., datë 24.05.2023 (*shkresa nr. 388/2023*), kallëzimin penal të kërkuesit ia ka dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (*Prokuroria Tiranë*), me arsyetimin se prej tij nuk rezulton ndonjë e dhënë për veprat penale në kompetencën lëndore të saj. Prokuroria Tiranë, pas regjistrimit të kallëzimit, në datën 20.06.2023 ka vendosur mosfillimin e çështjes penale.

4. Në datën 02.10.2023 kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë (*Gjykata e Posaçme*), duke kërkuar në mënyrë të përmblodhur: (i) shpalljen e çështjes penale lidhur me kallëzimin e tij brenda juridiksionit të posaçëm dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Posaçme dhe/ose ngritjen e mosmarrëveshjes së juridiksionit/kompetencës përpara Gjykatës së Lartë; (ii) shfuqizimin e shkresës nr. 388/2023 të Prokurorisë së Posaçme dhe të vendimit të mosfillimit të Prokurorisë Tiranë; (iii) fillimin e hetimeve nga Prokuroria e Posaçme.

5. Pas shqyrtimit të ankimit, Gjykata e Posaçme, me vendimin nr. 390, datë 23.10.2023, ka vendosur: (i) shpalljen e moskompetencës lëndore për kërkimin lidhur me shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të Prokurorisë Tiranë dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke u shprehur se për këtë disponim mund të parashtrohet mosmarrëveshje për kompetencën në Gjykatën e Lartë; (ii) mospranimin e ankimit në lidhje me kërkimet për shfuqizimin e shkresës nr. 388/2023 të Prokurorisë së Posaçme dhe parashtrimin e mosmarrëveshjes së kompetencave përpara Gjykatës së Lartë, duke u shprehur se për këtë disponim mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit.

6. Kërkuesi ka ushtruar rekurs të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë kundër atij vendimi, duke parashtruar mosmarrëveshjen e kompetencës lëndore. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2186, datë 19.12.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se mosmarrëveshja e kompetencave nuk mund të ngrihet nga palët, por vetëm nga gjykatat, ndërsa për pjesën e vendimit që ka disponuar mospranimin e ankimit për shfuqizimin e shkresës së Prokurorisë së Posaçme, kërkuesi ka pasur të drejtën e ankimit në Gjykatën e Posaçme të Apelit dhe jo drejtpërdrejt në Gjykatën e Lartë.

7. Në datën 13.02.2024, kërkuesi, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ankimi, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 25.03.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi** ka parashtruar në mënyrë të përmblodhur se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

8.1. *Të drejtat e aksesit dhe ankimit*, pasi disponimi i Prokurorisë së Posaçme është formalizuar në formën e shkresës së paankimueshme në gjykatë, me qëllim që veprimtaria hetimore e prokurorëve të mos kontrollohet nga gjykata.

- 8.2. *Parimi i barazisë para ligjit*, pasi Prokuroria e Posaçme ka mbajtur standarde të dyfishta. Në raste të ngjashme, ajo ka kryer hetimet dhe ka dërguar çështjet në gjykatën e posaçme, ndërsa për çështjen e tij ka gjetur mënyra për shmangien e kësaj procedure.
- 8.3. *Parimi i gjykatës së caktuar me ligj*, pasi çështja e tij duhet hetuar nga Prokuroria e Posaçme dhe duhet gjykuar nga gjykatat e posaçme. Konkluzioni i Prokurorisë së Posaçme për mungesën e veprave penale të kryera nga një grup i strukturuar kriminal, është i pabazuar dhe e nxjerr çështjen përfundimisht nga juridiksioni i posaçëm.
- 8.4. *Parimi i sigurisë juridike*, për shkak të pritshmërive të kërkuarit se çështjet që kanë të bëjnë me subjektet e posaçme do të hetohen nga Prokuroria e Posaçme dhe do të gjykohen nga gjykatat e posaçme.
- 8.5. *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, si rrjedhojë e kalimit të çështjes për kompetencë Prokurorisë Tiranë, ku kallëzimet e tjera penale të kërkuarit vazhdojnë të jenë në hetim prej 2 vjetësh, pa rezultat konkret.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Kolegji vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës. Ai është palë në procedimin penal objekt i ankimit kushtetues, për rrjedhojë ka formalisht interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural. Në kushtet kur kontrolli kushtetues ka një funksion *subsidiar*, ai mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor të themelit (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, Kolegji vëren se, në thelb, nëpërmjet ankimit kushtetues individual kërkuesi pretendon që të përcaktohen Prokuroria e Posaçme dhe Gjykata e Posaçme, si organe kompetente nga pikëpamja e lëndës për të proceduar me hetimin dhe gjykimin e çështjes penale të vënë në lëvizje me kallëzim prej tij. Prokuroria e Posaçme, me shkresën nr. 388/2023, ia ka përcjellë kallëzimin Prokurorisë Tiranë për kompetencë, ndërsa ankimi i kërkuesit ndaj kësaj shkrese nuk është pranuar nga Gjykata e Posaçme dhe as nga Gjykata e Lartë. Në këto kushte, Kolegji çmon se për të vlerësuar përmbushjen e kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive merr rëndësi të përcaktohet nëse shkresa nr. 388/2023 dhe vendimet gjyqësore që janë dhënë për ankimin ndaj saj kanë formë përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

13. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se, përjashtimisht, kontrollit të saj i nënshtrohen edhe ato vendime të ndërmjetme, karakteri i të cilave do të konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Ky përjashtim zbatohet vetëm nëse plotësohen njëherazi tre kushte: (i) kur shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; (ii) vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta të

jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Duke zbatuar standardin e mësipërm, Kolegji vlerëson se disponimi i prokurorit gjatë hetimit paraprak për kompetencën, edhe pse është kontrolluar gjyqësisht deri në Gjykatën e Lartë, nuk ka natyrë përfundimtare. Një disponim i tillë, pavarësisht llojit të aktit në të cilin është formalizuar – shkresë, vendim apo urdhër - ka natyrë të ndërmjetme, sepse nuk zgjidh në mënyrë përfundimtare themelin e çështjes penale. Në këtë këndvështrim, shkresa e prokurorit nr. 388/2023 nuk ka masën e duhur të autonomisë nga procesi i themelit, në kuptimin që të sjellë efekte të tilla që nuk mund të riparohen ose ndryshohen nga vendimi përfundimtar që do të zgjidhë në themel çështjen penale.

15. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriterin e shterimit paraprak të të gjitha mjeteve juridike efektive në dispozicion. Në këto kushte, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

16. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.